



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 41 (827845)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 13 tetor 2023

Gjeneralmajor Kingji priti Drejtorin e Planifikimit të Politikave të Mbrojtjes të NATO-s, z. Karl Ford

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji priti Drejtorin e Planifikimit të Politikave të Mbrojtjes dhe Sektorit të Planëzimit të NATO-s, z. Karl Ford. Gjeneralmajor Kingji gjatë fjalës së tij në takim falënderoi z. Karl Ford dhe ekipin e tij për mbështetjen në zhvillimin e kapaciteteve dhe modernizimin e Forcave të Armatosura. "Shqipëria do të vazhdojë të investojë në modernizim, të promovojë ndërveprueshmërinë dhe aktivisht të kontribuojë në përpjekjet e përbashkëta për ruajtjen e sigurisë kolektive. Kemi punuar që Prioritetet Kombëtare të

jenë në një linjë me prioritetet e NATO-s, dhe kemi përshtatur Planet e Mbrojtjes Kombëtare me Planet Rajonale të Modelit të Ri të Forcës së Aleancës...", - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji. Nga ana e tij, z. Ford, pasi adresoi një falënderim për Shqipërinë, për seriozitetin dhe përkushtimin e saj në përpjekjet dhe hapat konkrete për modernizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, theksoi se: "Së bashku, ne do të qëndrojmë të përkushtuar dhe të angazhuar të ruajmë vlerat demokratike të lirisë, paqes dhe sigurisë..."



» faqe 2

Ministri Peleshi: Shqipëria, solidaritet të plotë me popullin e Ukrainës, angazhim maksimal në forcimin e deterencës dhe mbrojtjes së Kosovës



Meetings of NATO Ministers of Defence

11-12 X 2023

Réunions des ministres de la défense de l'OTAN



faqe 3

Stërvitja "EOD Activity" me ekipin EOD të nëntë shteteve të Ballkanit

Në Batalionin e Xhenios u zhvillua stërvitja "EOD Activity" në kuadër të iniciativës BCHOD (Balkan Chiefs of Defense). Në këtë aktivitet përveç Shqipërisë morën pjesë dhe ushtarakë nga: Bosnje & Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania. Ky aktivitet u zhvillua në mjediset e Batalionit të Xhenios, ku fillimisht të gjithë pjesëmarrësit u pritën nga komandanti Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj. Më tej në ceremoninë e rastit u mbajt...



» Faqe 4

Strategjia "PËRÇAJ DHE SUNDO", nga antikiteti tek lufta hibride

"Divide et Impera", që nga latinishtja do të thotë: "Përçaj dhe sundo" e Niccolo Machiavellit, në librat e tij "De Principibus" dhe "Discorsi" të vitit 1513, u kthyen në moto të sundimtarëve në Romë dhe në botë. "Divide et impera" (përçaj dhe sundo) është një nga tre parimet politike të pushtetit, bashkë me "Fac et excusa" (vepro tani dhe justifikohu më vonë); dhe "Si fecisti, nega" (nëse kryen një krim, mohoje atë). Ky art, i sundimit si palë e tretë, duke shfrytëzuar dhe injektuar...



» Faqe 5

Perlat Musta "portieri i përjetshëm" i Partizanit

Perlat Musta, ish-portieri i Kombeutare shqiptare dhe i skuadrës së Partizanit, ka lindur në Vlorë në vitin 1958. Që në fëmijëri ai shfaqti prirje për t'u marrë me sport, veçanërisht me futbollin. Në moshën 10 vjeçare ai mendonte vetëm për futbollin, por ndryshe nga shokët e tij që preferonin të luanin në sulm, atij i pëlqente porta. Pasi mbaroi shkollën në qytetin e lindjes u regjistrua në shkollën e Mjeshtërisë Sportive, por nuk arriti të kapte normat, kështu që nuk u pranua. Më pas, prindërit, të cilët (siç shprehet vetë mjeshtri...



» Faqe 6

Forcave të Armatosura të RSH-së i shtohet struktura më e re, Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut

Në kuadër të ndryshimeve strukturore të Forcave të Armatosura, në Poshnje u zhvillua ceremonia e krijimit të Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, pjesë e Forcës Tokësore, si dhe emërimi i komandantit të këtij regjimenti, kolonel Gëzim Marku.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigadë Ilir Xhebexhia, drejtorë drejtorish në SHP, komandantë të reparteve të varësisë të Forcës Tokësore, etj.

Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, gjeneralmajor Arben Kingji, duke e cilësuar moment të veçantë krijimin e regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, si një nga strukturat më të reja që i shtohen FARSH-së, që do të bëjë të mundur rritjen e mëtejshme të kapaciteteve ushtarake në rajonin jugor të vendit, u shpreh ndër të tjera: “Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, së bashku me atë të Këmbësorisë së Veriut dhe të Mbështetjes me Luftim, janë strukturat më të reja të Forcës Tokësore, të cilat pa dyshim që do të fuqizojnë e zhvillojnë më tej kapacitetet e kësaj force. Kalimi në strukturën e re Organizative ka bërë që të krijohen dhe funksionojnë edhe strukturat më të reja në Forcat e Armatosura, me fokus rritjen e fuqisë së zjarrit, mbrojtjen kundërajrore, sigurinë kibernetike, si dhe rritjen e kapaciteteve ajrore dhe detare...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.



sura, në komandën e Forcës Detare dhe Forcës Ajrore. Nevoja për organizimin e strukturave të reja ka lindur si rrjedhojë e ndryshimit të mjedisit të sigurisë në rajon dhe me gjerë, sikundër edhe ju mund ta keni ndjekur në mediat e ndryshme vizive dhe rrjetet sociale, lufta në Ukrainë, situata në Kosovë apo konflikti Palestino-Izraelit, kërkon që të gjitha vendet anëtare NATO-s të përshtatin dhe sinkronizojnë kapacitetet

ushtarake...”, - u shpreh gjeneralmajor Kingji. Më tej, gjatë fjalës së tij gjeneralmajor Arben Kingji solli në vëmendje se procesi i transformimit të forcave të NATO-s, të cilat po kalojnë në një model të ri të forcës, implikojnë edhe Forcat e Armatosura Shqiptare, kërkojnë uljen e kohës së reagimit kundërt kërcënimeve dhe rreziqeve dhe rritjen e kapaciteteve operacionale. “...Në këto kushte, ne duhet që të përshtatem me

mjedisin e ri të krijuar, të përgatitemi dhe stërvitemi për t’iu përgjigjur të gjitha sfidave të sigurisë dhe realizimin e një spektri të gjerë operacionesh dhe detyrash, brenda dhe jashtë vendit, do të jetë synimi i gjithë veprimtarisë të Forcave të Armatosura. Paralelisht me implementimin e strukturës së re, e cila përfshin edhe komponentin rezervist, vëmendje e veçantë do t’i kushtohet modernizimit të Forcave tona të Ar-

matosura, me fokus rritjen e fuqisë së zjarrit, mbrojtjen kundërajrore, sigurinë kibernetike, si dhe rritjen e kapaciteteve ajrore dhe detare...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

Në përfundim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh besimplotë se Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut do të shënojë arritje të mëtejshme në të gjitha aspektet: “Ndaj ju ftoj që të punojmë të gjithë së bashku për të realizuar me nder misionin tonë të shenjtë në mbrojtje të integritetit dhe vlerave tona kombëtare”.

Në sajë të zhvillimeve të reja të procesit të modernizimit dhe domosdoshmërisë së zhvillimeve në mjedisin aktual të sigurisë, Forcat e Armatosura iu nënshtruan ndryshimeve të reja strukturore, më konkretisht në Forcën Tokësore me krijimin e Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut, Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhe Regjimentit të Mbështetjes me Luftim, krahas Regjimentit të Operacioneve Speciale (të krijuar në Mars 2021) dhe Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë me njësinë bërthamë batalionin e dytë. Një risi e këtyre ndryshimeve është atashimi i komponentëve rezervist si pjesë e këtyre njësisve, i cili është në fazën e projekt-ligjit.

Gjeneralmajor Arben Kingji priti Drejtorin e Planifikimit të Politikave të Mbrojtjes dhe Sektorit të Planëzimit të NATO-s, z. Karl Ford

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji priti Drejtorin e Planifikimit të Politikave të Mbrojtjes dhe Sektorit të Planëzimit të NATO-s, z. Karl Ford.

Gjeneralmajor Kingji gjatë fjalës së tij në takim falënderoi z. Karl Ford dhe ekipin e tij për mbështetjen në zhvillimin e kapaciteteve dhe modernizimin e Forcave të Armatosura. “Shqipëria do të vazhdojë të investojë në modernizim, të promovojë ndërveprueshmërinë dhe aktivisht të kontribuojë në përpjekjet e përbashkëta për ruajtjen e sigurisë kolektive. Kemi punuar që Prioritetet Kombëtare të jenë në një linjë me prioritetet e NATO-s, dhe kemi përshtatur Planet e Mbrojtjes Kombëtare me Planet Rajonale të Modelit të Ri të Forcës së Aleancës...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral major Kingji.

Nga ana e tij, z. Ford, pasi adresoi një falënderim për Shqipërinë, për seriozitetin dhe përkushtimin e saj në përpjekjet dhe hapat konkrete për modernizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, theksoi se: “Së bashku, ne do të qëndrojmë të përkushtuar dhe të angazhuar të ruajmë vlerat demokratike të lirisë, paqes dhe sigurisë, vetëm në sajë të unitetit dhe solidaritetit mes Aleancës. Tek Shqipëria, shohim një aleat të besueshëm dhe promovues i



qëndrueshmërisë dhe paqes në rajon e më gjerë.”

Takimi u zhvillua në kuadër të takimeve në nivele të larta me përfaqësuesit e NATO-s dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbi Planifikimin e Politikave të Mbrojtjes dhe Planëzimit, për identifikimin dhe zhvillimin e objektivave dhe kapaciteteve mbi bazën e të cilave harmonizohen planet kombëtare të mbrojtjes me planet e NATO-s, si dhe në ofrimin e forcave dhe aftësive të nevojshme në mënyrë sa më efektive dhe maksimizimin e koherencës në fusha të ndryshme të planifikimit.

Në kuadër të punimeve të Ministerialit të Mbrojtjes të NATO-s, një vëmendje të veçantë mori Takimi i Këshillit NATO - Ukrainë, i zhvilluar për herë të parë në nivel të ministrave të mbrojtjes, me qëllim afrimin e saj me Aleancën, duke shënuar një kapitulli të ri në marrëdhëniet NATO - Ukrainë. Në fjalën e tij ministri Peleshi rikonfirmoi se Shqipëria do të vazhdojë ndihmën e saj politike, ushtarake dhe humanitare për Ukrainën: “Ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me qeverinë dhe popullin e Ukrainës dhe mbështesim aspiratat e tyre për t’u anëtarësuar në NATO”, - u shpreh ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi u takua në Bruksel, me ministrin e Mbrojtjes të Ukrainës, z. Rustem Umierov. Gjatë këtij takimi, z. Peleshi dhe z. Umierov biseduan mbi situatën aktuale në Ukrainë dhe rëndësinë e mbështetjes nga Aleanca, si një element thelbësor në rezistencën ndaj luftës me Rusinë.

Ministri Umierov, shprehu mirënjohjen ndaj vendit tonë dhe falënderoi për mbështetjen e gjithanshme që Shqipëria i ka ofruar Ukrainës, qysh prej fillimit të luftës. Lufta në Ukrainë ishte fokus kryesor i Takimit të Ministrave të Mbrojtjes, të mbledhur në selinë e NATO-s në Bruksel.

Vijimi i mbështetjes së vendeve të Aleancës ndaj Ukrainës, në zbatim të vendimeve të Samitit të Vilniusit, u diskutua fillimisht në një takim të veçantë të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, që u mbajt në fillim të Takimit formal të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, ku morën pjesë mbi 50 vende të ndryshme aleate dhe partnere të NATO-s. Gjatë këtij takimi u theksua nevoja imediate për mbështetjen e Ukrainës me kapacitete ushtarake si: sisteme armatimi, artileri dhe municione të kalibrave të ndryshëm me qëllim mbrojtjen e infrastrukturës kritike të saj, nga agresioni rus.

Gjatë takimit, vendet aleate mbajtën qëndrim të unifikuar për vijimin e kontributeve, si dhe ruajtjen e solidaritetit dhe kohezionit në mbështetje të popullit ukrainas dhe luftës së tij. Gjithashtu, mbështetje të palëkundur në rrugëtimin e Ukrainës drejt integritetit euroatlantik.

Zhvillimet në Veri të Kosovës patën gjithashtu një rëndësi të madhe në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s. Si pjesë e këtij takimi, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shprehu angazhimin e vendit tonë për zbatimin e vendimeve të marra në Samitin e Vilniusit mbi zhvillimin e planeve rajonale dhe strukturën e re të forcave, si dhe theksoi rëndësinë që ka realizimi i të gjithë familjes së planeve të shkurajimit dhe mbrojtjes, për të garantuar Aleancën nga kërcënimet e mundshme. Në zbatim të modelit të ri të forcave të NATO-s, është miratuar struktura e re e Forcave të Armatosura, si dhe do të kontribuojmë në zbatimin e planeve duke përshtatur praktikën tona dhe vendosur në dispozicion infrastrukturën kritike si ajo e Bazës së Kuçovës, Portin e Porto Romanos dhe ndërtimi i Korridorit VIII.

Sipas ministrit Peleshi, “Shqipëria ka një vullnet politik të qartë dhe do të vijojë të mbështesë me një qasje gjithëpërfshirëse masat për forcimin e deterencës dhe mbrojtjes, duke rritur edhe më tej kontributin në operacione dhe në misione si në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Irak, në Vigjilencën e Përforuar të NATO-s në Bullgari, Rumani dhe në detin Mesdhe”.



Ministri Peleshi: Shqipëria, solidaritet të plotë me popullin e Ukrainës, angazhim maksimal në forcimin e deterencës dhe mbrojtjes së Kosovës



Duke u fokusuar në situatën mbi Ballkanin Perëndimor, ministri Peleshi gjatë fjalës së tij dënoi me ashpërsi sulmin e sofistikuar terrorist në Veri të Kosovës, si një tentativë për destabilizimin e rajonit. “Për më tepër, - shtoi ai, reagimi i Beogradit duke heroizuar sulmuesit e 24 shtatorit në Banjska si dhe dërgimi i trupave dhe kapaciteteve ushtarake afër kufijve të Kosovës janë ngjarje të papranueshme dhe të dënueshme, prandaj BE-ja veçanërisht duhet të mbajë një qëndrim të prerë ndaj akteve të tilla dhe të shprehet hapur ndaj qeverisë serbe”. Ministri Peleshi theksoi se NATO dhe BE duhet të

bëjnë më tepër për Ballkanin. Gjuha dhe mesazhet që përcillen nga i gjithë komuniteti perëndimor duhet të jenë të qarta dhe të balancuara, edhe nën dritën e dinamikave të fundit.

Zoti Peleshi theksoi se vendi ynë mbështet plotësisht mandatin e KFOR-it dhe është i angazhuar intensivisht me aleatët për të parandaluar një përshkallëzim të situatës, duke kontribuar në të njëjtën kohë për lehtësimin e dialogut Prishtinë-Beograd. Gjithsesi, sipas ministrit Peleshi, shikohet si e nevojshme një vendimmarrje politike për të përmirësuar dhe maksimizuar angazhimin e KFOR-it në Kosovë, duke përmirësuar bashkëpunimin me palët kryesore të interesuara. “KFOR duhet të intensifikojë patrullimet përgjatë kufirit Kosovë-Serbi në sinkronizim me Policinë e Kosovës, e cila mbetet reaguesi parë i sigurisë në tërë territorin e Kosovës, si dhe me EULEX-in”, - u shpreh z. Peleshi.

Në vëmendje të Ministerialit të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s ishte edhe mbështetja e palëkundur për Ukrainën, në përpjekjet e saj kundër agresionit rus. Aleatët shprehën solidaritetin e tyre me Izraelin, duke dënuar njëzëri sulmet, pengmarrjen dhe vrasjen e civilëve për shkak të sulmeve të Hamasit. Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë, z. Mario Banožić, në emër edhe të ministrave të Mbrojtjes së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut shprehu qëndrimin e vendeve tona në solidaritet të plotë me Izraelin. Ai dënoi sulmet terroriste dhe vlerësoi të drejtën e vendit për t’u mbrojtur në proporcionalitet kundër këtyre akteve të pajustificueshme të terrorit. Vendet tona do të kenë gjithmonë të njëjtën mbështetje sikundër dhe Aleanca kundrejt akteve të tilla të cilat cenojnë sigurinë euroatlantike.

Gjatë punimeve të këtij takimi, nga disa nga vendet aleate u nënshkrua dhe Letra e Qëllimit, lidhur me iniciativën shumëkombëshe për lehtësimin e kufizimeve ndër-kufitare në hapësirën ajrore të vendeve aleate, për aktivitetet ajrore të NATO-s. Të gjitha vendet angazhohen në kuadër të masave për rritjen e operacionalitetit dhe zbatimin të planeve të mbrojtjes për krijimin e lehtësirave procedurale në përdorimin e hapësirës ajrore.





Stërvitja "EOD Activity" me ekipin EOD të nëntë shteteve të Ballkanit

Në Batalionin e Xhenios u zhvillua stërvitja "EOD Activity" në kuadër të iniciativës BCHOD (Balkan Chiefs of Defense).

Në këtë aktivitet përveç Shqipërisë morën pjesë dhe ushtarakë nga: Bosnje & Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania.

Ky aktivitet u zhvillua në mjediset e Batalionit të Xhenios, ku fillimisht të gjithë pjesëmarrësit u pritën nga komandanti Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj.

Më tej në ceremoninë e rastit u mbajt dhe një fjalë përshëndetëse nga drejtori i SHP, kolonel Aleksandër Pando.

Komanda Mbështetëse u përfaqësua nga shefi i Shtabit, kolonel Arben Dhuli.

Në këtë aktiviteti u paraqitën 3 prezantime dhe përkatësisht njëra rreth Shqipërisë si vend pritës dhe organizues i aktivitetit BCHOD, një rreth Batalionit të Xhenios dhe i fundit rreth kompanisë EOD.

Më tej u vijua me një paraqitje dhe demonstrim të pajisjeve EOD/IEDD që janë në posedim nga kompania EOD.

Aktiviteti vijoi me vizitën te vendi i trajnimit (CTA Close Training Area) i kompanisë EOD, ku pjesëmarrësit u njohën me terrenet stërvitore të kompanisë EOD, më tej aktiviteti vazhdoi në



poligonin EOD që gjendet në repartin 1060 të FT-së.

Specialistët e kompanisë kishin planëzuar dhe organizuar disa prej incidenteve të shkallës më të lartë të kompleksitetit dhe vështirësisë si: neutralizimi dhe asgjësimi i një pajisjeje të improvizuar eksplozive brenda një makine (VBIED Vehicle Born Improvised Explosive Device).

Gjatë aktivitetit u realizuan dhe 4 incidente të tjera për asgjësimin e municioneve konvencionale me metodën e shmangies së detonimit.

Në nder të pjesëmarrësve, zëvendëskomandanti, Komandant në detyrë i KM priti përfaqësuesit dhe u dhuroi "monedhën" e KM-së.



Djemtë e batalionit të dytë të këmbësorisë së Forcës Tokësore, morën pjesë në stërvitjen ndërkombëtare "Cambrian Patrol 2023", në Mbretërinë e Bashkuar, të cilët u renditën në vendin e dytë, mes 37 vendeve pjesëmarrëse. Djemtë tanë treguan karakter dhe aftësi fizike të jashtëzakonshme në malet Kambrian në Uells, duke përshkruar 65 km në këmbë, të ngarkuar me rreth 35 kg pajime, në më pak se 48 orë.



Anija P-134 "Butrinti" zhvilloi stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane "Frankfurt A1412"

Anija P-134 "Butrinti" pjesë e misionit të NATO-s, në detin Egje, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare Gjermane "Frankfurt A1412", në ujërat ndërkombëtare.

Gjatë stërvitjes, komandanti i Grupit Detar të aktivitetit të NATO-s në detin Egje zhvilloi një vizitë në bordin e anijes P-134, gjatë së cilës u diskutua mbi udhëzimet në lidhje me ecurinë e misionit, fluksin e emigrantëve në zonën tonë të përgjegjësisë, taktikat e përdorimit të emigrantëve për kalimin e kufirit, monitorimin e rajonit dhe raportimin te anija flamurtare.

Gjatë stërvitjes u zhvilluan disa seriale që lidhen me procedurat e komunikimit, furnizimit në det, operacionet e ndalimit detar, sipas standardeve të manualeve të NATO-s.

Bashkëpunimi koordinues me aleatët është një kontribut i vyer për sigurinë detare të Aleancës. Në një periudhë të shkurtër kohore, për 3 muaj pjesëmarrje në mision, anija "Butrinti" iu ka ardhur në ndihmë një numri të lartë emigrantësh, të cilët ndodheshin në rrezik për jetën.

Në përfundim të stërvitjes komandanti i anijes Komandë dhe Task Forcës shprehën falënderimet e tyre për zhvillimin me sukses të stërvitjes dhe profesionalizmit të treguar duke iu uruar një mision të mbarë, në detin Egje kontingjentit II.



Studentët e AFA-së marrin pjesë në seminarin "Leadership Seminar"

Dy studentë të ciklit të parë të studimeve Bachelor, dega Navigim dhe Komandim detar, viti III, Fakulteti i mbrojtjes dhe Sigurisë, në Akademinë e Forcave të Armatosura morën pjesë në seminarin "Leadership Seminar" (Naval seminar), në Akademinë "Marina Militare", Livorno, Itali. Në këtë seminar u zhvilluan konferenca të ndryshme me temë për Leadership-in detar dhe Detarinë, ku pjesëmarrës ishin vende anëtare të NATO-s si: Polonia, Gjermania, Spanja, Danimarka, Turqia etj., Afrika dhe kadetë të vitit të fundit akademik në shkollën e marinës, Itali.





KOLONEL HYSNI GJERGJI

Strategjia "PËRÇAJ DHE SUNDO", nga antikiteti tek lufta hibride



"Divide et Impera", që nga latinishtja do të thotë: "Përçaj dhe sundo" e Niccolo Machiavellit, në librat e tij "De Principibus" dhe "Discorsi" të vitit 1513, u kthyen në moto të sundimtarëve në Romë dhe në botë. "Divide et impera" (përçaj dhe sundo) është një nga tre parimet politike të pushtetit, bashkë me "Fac et excusa" (vepro tani dhe justifikohu më vonë); dhe "Si fecisti, nega" (nëse kryen një krim, mohojë atë). Ky art, i sundimit si palë e tretë, duke shfrytëzuar dhe injektuar mosmarrëveshjet mes dy palëve kryesore në konflikt, është përdorur me shekuj në shumë luftëra dhe nga shumë udhëheqës në tërë botën. "Përçaj dhe sundo" si parim i sundimtarëve, ka filluar që nga krijimi i shtetit në të gjitha rajonet e botës dhe vazhdon edhe sot. Kjo taktikë politike, ushtarake, sociale dhe psikologjike, sipas të cilës ekzistojnë, është edhe mjet për zhvillimin e shteteve dhe fuqive botërore. Përdorimi i kësaj teknike ka për qëllim të fuqizojë një shtet për të kontrolluar, popullata ose fraksione me interesa të ndryshme, të cilët po të jenë në aleancë bashkë, mund të kundërshtojnë dhe të mposhtim sundimtarin.

Machiavelli e identifikon një aplikim të ngjashëm në strategjinë ushtarake, duke e përshkruar në librin VI të artit të luftës në vitin 1521. Sipas "L'arte della guerra" një drejtues ushtarak duhet të përpjket të përçajë forcat e armikut. Machiavelli na mëson, që për ta bërë kundërshtarit më të dobët dhe të dyshojë tek njerëzit që ai beson, ai duhet detyruar të ndajë forcat dhe fuqinë e tij. Strategjia e përçarjes dhe e sundimit u është atribuar sundimtarëve, duke filluar nga Luigji XI i Francës deri te Hasburgët me deklarinim: "Do të ishit të pamposhtur nëse do të ishit të pandashëm". "Përçaj dhe sundo" si strategji e sundimtarit, përdoret nga fuqitë ushtarake për të dobësuar aleatët dhe aleancat mbrojtëse të kundërshtarit. Ky parim përmbushet kur propaganda përçarëse përhapet dhe besohet brenda shteteve në konflikt dhe aleancës mes tyre. Pasi aleanca do të dobësohet ose shpërbëhet, ky vakum do t'i lejojë shtetit që e synon, të arrijë më lehtë dominancën ushtarake, se sa tek ish-aleatët një e nga një. Parimi "përçaj dhe sundo" është aktualisht më i efektshëm në ato shoqëri ku konkurrojnë komunitete, kultura, etni, besime, raca etj., pasi secila natyrshëm mbron historinë dhe traditat e veta.

Përgjatë vitit 2023, shohim gjithnjë edhe më dukshëm ravijëzimin e kësaj teorie të luftës të përdorur nga Putin, si pjesë e doktrinës "Gerasimov", kryesisht në ish-republikat e BS por edhe më gjerë. Strategjia "përçaj dhe sundo" në Ukrainë, po vërteton transferimin e kësaj teorie shekullore në ditët tona, si pjesë të doktrinës "Gerasimov", sipas të cilës "çdo gjë është luftë dhe beteja është kudo".

Lufta në Ukrainë ishte shkak që Rusia të fillojë fushatën përçarëse për Turqinë, që të kundërshtonte zgjerimin e NATO-s, duke rikrijuar incidente për popullsinë myslimane, siç ishte ajo e djegies së Kuranit në Suedi. Rasti i ftesës së Suedisë dhe Finlandës për t'u anëtarësuar në NATO, pas agresionit të 24 shkurtit 2022, është qartë dora e Moskës si i vetmi faktor që ka interes kundër zgjerimit. Në këtë kurth sigurisht Ankaraja nuk ra, pasi ishte e qartë se pala që përfiton në këtë rast, ishte vetëm Rusia. Tashmë nuk është sekret se Rusia ka kohë që po bën fushatë dhe presion ndaj kombeve të tjera, për t'i nxjerrë ato nga kursi perëndimor dhe për të krijuar kushte që në pushtet në këto vende të vijnë forcat pro ruse, të krijojë çarje të aleancës mes tyre. Hapur, në shkurt 2022, Lavrov i dërgon letër gjithë qeverive të shpreheshin pro ose kundër Rusisë, duke synuar të përçajë aleancën për Ukrainën.

Në Forumin Ekonomik Lindor, në Vladivostok, më 12 shtator 2023, Putin deklaroi me qëllim përçarjen e aleatëve të Ukrainës se "Bashkimi Sovjetik ka gabuar kur pushtoi Hungarinë më 1956 dhe Çekosllovakinë më 1969". Bashkimi sovjetik dje dhe Rusia sot, është përpjekur paseshtur të kontrollojë vendet e ish-BRSS, duke i përçarë dhe armiqësuar aleancën tyre.

Me gjithë këtë përpjekje, nga viti 2000, kur Putin erdhi në pushtet, deri sot janë anëtarësuar në NATO Lituania, Letonia dhe Estonia, ndërsa aktualisht është prezent në Gjeorgji, Ukrainë e

Moldavi. Bullgaria dhe Polonia janë shënjestruar nga Rusia për t'u influencuar, përmes partive dhe liderëve politikë pro rusë në këto shtete. Putin, që në vitin 2008, këmbëngulte duke u përpjekur të bindë liderët polakë se Ukraina është një shtet 'i rremë'. Përkundër përpjekjeve përçarëse ruse Ukraina krijoi lidhje sociale, ekonomike dhe politike me Poloninë, ku më 2022, rreth një milion ukrainas jetonin dhe punonin në Poloni.

Rusia ka objektiva gjeopolitike mbi secilin shtet të rajonit dhe me synim të ndikojë në Ballkanin Perëndimor, përmes taktikës "përçaj dhe sundo", duke përdorur mjete të shumta ndikimi dhe armiqësimi mes shteteve ballkanike. Moska ka depërtuar për të përçarë popujt e rajonit përmes armëve "hibride", shërbimeve të inteligjencës, "mercenarëve", blerjes së liderëve politikë, mediave sociale, madje edhe të kishës ortodokse. Duke bërë presion me këto armë, Kremli synon të dobësojë vendimmarrjen e unifikuar të shteteve të veçanta të BE-së. Kremli nuk i pushton dot ushtarakisht, por duke i vendosur aleatët kundër njëri-tjetrit, mund të dobësojë fuqinë e tyre të përbashkët, si dhe të "injektojë rusishten" në vendimet e politikës së jashtme së tyre, duke parandaluar krijimin e një fronti të përbashkët shumëkombësh.

Polonia dhe Ukraina, kanë trashëguar armiqësi, të cilën Kremli e ka investuar me tekste shkollore për nxënësit, me propagandë, trazira etj. Për ringjalljen e armiqësisë mes tyre, Rusia e vë theksin tek ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore, në të cilën disa guerilë ukrainas vranë qindra civilë polakë. Synimi, të rriten ndjenjat hakmarrëse dhe të tregohet se polakët janë anti-ukrainas, dhe ukrainasit janë anti-polakë. Në mars 2022, "Pravda.ru" e paraqiti Poloninë si një hienë, duke festuar mbi kufomën e Ukrainës.

Putin djallëzishit hedh idenë përçarëse e Varshava mund të rimarrë atë që dikur ishte Polonia lindore dhe tani është Ukraina perëndimore. Televizionet pro ruse, kanë inskenuar incidente me nacionalistët polakë, që pretendojnë se po digjinin flamujt ukrainas gjatë festimeve të Ditës së Pavarësisë së Polonisë. Mediat propagandistike të Rusisë, janë përpjekur të "helmojnë" edhe marrëdhëniet mes Ukrainës dhe Bjellorusisë për ta mbajtur Minskun të lidhur fort rreth vetes. Më 4 tetor kryetari i parlamentit të Moldavisë, Adrian Candu, theksoi se, "qeveria mendon që Rusia po financon partitë politike dhe liderët e tyre. Nën regjinë e Moskës po ushqehet propaganda ruse me tensionet midis Serbisë me Kroacinë, Malin e Zi; Maqedonisë me Greqinë, Rumanisë me Moldavinë, apo midis HUMANIS me Hungarinë.

Sulmi i papritur i "HAMAS" kundër Izraelit është nga më të përgjakshmit për vitin 2023. Më shumë se 600 izraelitë janë vrarë, që prej nisjes së sulmeve të Hamas-it më 7 tetor, sipas qeverisë izraelite. Gjithashtu mbi njëqind persona janë rrëmbyer dhe ka mbi dy mijë të plagosur. Nga ana tjetër, në Gaza janë vrarë të paktën 313 persona, si pasojë e goditjeve ajrore të Izraelit. Taktika e njëjtë si në Rusi, pengje për shkëmbim dhe sulm

frontal në të gjithë frontet, duke sfiduar sigurinë dhe inteligjencën më të vlerësuar në botë, atë izraelite. Në pamje të parë, nëse nuk është kurth i Izraelit për fillimin e fushatës ushtarake, kjo është sfida e dytë më e rëndë që një grup terrorist i bën një shteti, pas talebanëve para dy vitesh në Afganistan. Irani është deklaruar hapur si palë e tretë që mbështet "Hamas-in" dhe pas saj në aleancë dhe me interes të plotë jetik është Rusia.

Ndërhyrja ruse në Serbi është e hapur, pasi Moska cakton edhe anëtarët e kabinetit qeveritar serb, siç veptoi pas zgjedhjeve në prill të këtij viti, kur Aleksandër Vuçiq, pas vizitës në Moskë, detyrohet të rifusë në kabinet si zëvendëskryeministër dhe ministër të Jashtëm pro rusin e deklaruar, Ivica Dačić. Për ta mbajtur luftën të ndezur mes serbëve dhe shqiptarëve, sa herë ata i afrohen një marrëveshje paqe, krijohet një incident për t'i mbajtur popujt larg paqes.

Nëse do të analizojmë 24 shtatorin 2023, do të arrinin në përfundim se ka një palë të tretë të interesuar. Në materialet e kapura nga policia, janë gjetur dokumente që dëshmojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në këtë aksion të kriminelit Millan Radoičiq, bashkë me truporjen e Alaeksandër Vulin, Drejtor i BIA, të cilët janë në listën e zezë të SHBA-së. Radoičiq ishte nën aktakuzë edhe si "udhëheqës i grupit kriminal", i cili u akuzua edhe për vrasjen Oliver Ivanović, por që është tërhequr në mars të vitit 2021, por pa prova. Nëse kërkojmë (cui prodest) nga këto akte, përgjigja nga Beogradi do na çojë në Moskë, e cila e përdor sa herë që i nevojitet një konflikt ndëretnik. Kosova e pavarur, në paqe dhe e njohur nga Serbia, do t'i hiqte Rusisë mundësinë e kontrollit, vartësisë dhe presionit mbi Beogradin, si dhe të drejtën për ta përdorur Kosovën, si "precedent" nga statusi i republikave të aneksuara Donbas, Luhansk dhe Donetsk.

Në Nish, është një qendër inteligjence, përmes së cilës rusët përgjojnë dhe zhvillojnë

trajnime për aksione në terren. Institucionet e Kosovës, në disa raste, kanë shpallur persona të padëshirueshëm diplomatë rusë, duke i detyruar të largohen për veprimtari subversive nga Kosova.

"Putin gjithmonë e lë hapur një mundësi. Në çdo moment që i duhet një krizë, ai mund të krijojë një të tillë, në Kosovë, në Ukrainë apo në shtetet Baltike", - thotë Gjenerali Uesli Clark. Strategjia për të vendosur kontroll ushtarak në Kosovën veriore sipas aksiomës ruse "Perëndimi nuk do ta pranojë në fillim aneksimin, por më vonë do mësohet me faktin e kryer, siç ndodhi në Krime". Serbia ka marrë 6 aeroplanë luftarakë MiG-29 nga Rusia dhe nga ana tjetër deklaroi veten ushtarakisht neutrale!?

Armët e konfiskuara në Bansjkë, janë me prejardhje nga Rusia dhe të dala nga depot e ushtrisë serbe. Mercenarët terroristë ishin të gjithë paramilitarë serbë, të armatosur, të trajnuar, të mbështetur, të strehuar dhe madje të vrarë nderohen zyrtarisht si dëshmorë. Vetëm banorët serbë dhe shqiptarë nuk janë të interesuar për luftën, pasi i kanë akoma plagët e freskëta të saj. Realiteti në popullsinë serbe është totalisht ndryshe nga propaganda e Moskës, sepse statistikisht serbët emigrojnë për jetë më të mirë vetëm në perëndim, askush në Rusi!?

Një tjetër rast i palës së tretë përfituese është edhe hakimi i "Homeland Justice" ndaj sistemeve elektronike të shtetit shqiptar vitin e kaluar. MEK (opozita iraniane), hakoi mbi 5000 kamera sigurie dhe 150 faqe interneti të Bashkisë së Teheranit. MEK e kryen sulmin nga Manza e Durrësit, duke e implikuar Shqipërinë pa vullnetin e saj në një incident ndërkombëtar. Ky rast është një shembull i implikimit të vendit tonë, si palë në një konflikt midis qeverisë iraniane dhe në favor të opozitës së saj, MEK. Ngjashëm ka ndodhur në luftën italo-greke, kur Italia sulmon Greqinë nga Shqipëria, duke e përfshirë në një çështje ligjore ndërkombëtare, akoma të pazgjidhur përfundimisht midis dy shteteve.

Me pyetjen "cui prodest" mund të shpjgohet edhe fryma e anti-amerikanizmit, e cila nga mos ekzistence deri para pak vitesh, po reflektohet mes individëve dhe forcave politike shqiptare. Kush përfiton nga lëkundja e marrëdhënies shekullore miqësore mes SHBA dhe Shqipërisë? Gjykoj se në pamundësi për të krijuar në Shqipëri parti politike pro ruse, Moska ka zgjedhur të nxitë dhe ushqejë anti-amerikanizmin, duke synuar përçarjen dhe dëmtimin e aleancës shekullore shqiptaro-amerikane. Fatkeqësisht gjenden kudo në botë dhe rajonin tonë "liderë që flenë si pro amerikanë dhe zgjojnë anti amerikanë e anti BE". Për të fituar mbi strategjitë "përçaj dhe sundo" të sundimtarëve, si dhe për të neutralizuar armët përçarëse të luftës hibride të Moskës, por edhe Pekinit, nevojitet që çdo qeveri e shënjestruar prej tyre, të rrisë ndërgjegjësimin e publikut ndaj teorisë së luftës "Divide et impera".

Mosmarrëveshjet që ekzistojnë mes shteteve, prej një kohe të gjatë, nuk mund të zhduken brenda ditës, por çdo shoqëri përfshirë edhe shoqërinë shqiptare, duhet të bëhet e vetëdijshme se gjithmonë ka një palë të tretë "grabitqare", e cila do të synojë t'i shfrytëzojë këto mosmarrëveshje në funksion të interesit dhe avantazhit të vet gjeopolitik.



Perlat Musta "portieri i përjetshëm" i Partizanit

Perlat Musta, ish-portieri i Kombëtares shqiptare dhe i skuadrës së Partizanit, ka lindur në Vlorë në vitin 1958. Që në fëmijëri ai shfaq prirje për t'u marrë me sport, veçanërisht me futbollin. Në moshën 10 vjeçare ai mendonte vetëm për futbollin, por ndryshe nga shokët e tij që preferonin të luanin në sulm, atij i pëlqente porta. Pasi mbaroi shkollën në qytetin e lindjes u regjistrua në shkollën e Mjeshtërisë Sportive, por nuk arriti të kapte normat, kështu që nuk u pranua. Më pas, prindërit, të cilët (siç shprehet vetë mjeshtri për gazetën "Ushtria") nuk kishin dëshirë që të merrej me sport pasi kështu ishte psikologjia e asaj kohe, i sugjeruan të shkonte në shkollën "Skënderbej". Megjithatë, për fatin e tij të mirë aty gjeti një terren shumë favorizues për të ndjekur pasionin e tij, pasi siç dihet në ato vite shkolla "Skënderbej" ishte një fidanishte që furnizonte me futbollistë ekipin e Partizanit. Pra lidhja e tij me klubin e Partizanit, duket se u shenjua që në atë vit.

Legjenda e portës shqiptare ka bërë paraqitje të paharrueshme me Kombëtaren shqiptare, ndër të cilat në mendjet e tifozëve të asaj periudhe janë skalitur ndeshjet e mrekullueshme ndaj Gjermanisë, Polonisë dhe takimi i paharrueshëm ndaj Belgjikës. Ai do të mbahet mend si "portieri i përjetshëm" i Partizanit, që nuk e tradhtoi asnjëherë klubin edhe në momentet më të vështira.


Futbolli shqiptar ndër vite ka pasur një traditë të shkëlqyer për sa i takon repartit më defensiv dhe padyshim që një nga emrat më të spikatur në portë ka qenë Perlat Musta, ose siç njihet nga të gjithë, "gardiani" i portës kuqezi. Musta, i cili ka shërbyer për ngjyrat e Partizanit dhe përfaqësues shqiptar për më shumë se dy dekada, përbën një nga faqet e lavdishme të historisë së futbollit tonë kombëtar.

Janë me mijëra tifozët e Partizanit që ende mbajnë mend pritjet e shkëlqyera të tij në qindra takime në kampionat. Ai tashmë është larguar prej vitesh nga fushat e blerta, por gjithmonë është pranë të rinjve për t'i ndihmuar të ecin fuqishëm dhe me dinjitet në rrugën e bukur por të vështirë të futbollit.

Të gjithë e kujtojnë me respekt "vlonjatin" e Partizanit, që në atë kohë krahasohej për nga reflekset dhe hedhjet e rrufeshme me Dasajevin e madh.

Gjithsesi, siç shprehet edhe vetë ai, kjo nuk është një çështje thjesht individuale, por i takon një brezi të tërë futbollistësh që sakrifkuan shumë dhe bënë që emri i Shqipërisë të dëgjohej në arenën ndërkombëtare, ndërkohë që përveç kënaqësisë shpirtërore, nuk provuan asnjë "luks" tjetër gjatë dhe pas karrierës së tyre.

Perlat Musta, kampion me fanellën e kuqe më 1979, 1981 dhe 1987 dhe fitues i kupës me 1980, 1991 dhe 1997, njëkohësisht, ai luajti 23 ndeshje me Kombëtaren nga 1981-1993. Njëkohësisht mbeten të paharruara paraqitjet në takimet ndërkombëtare historike me Partizanin kundër Rijeka, Austria Vjenë, Malmo e Celtic. Ndeshja kyçe e tij në Lisbonë solli edhe një krisje të karrierës së tij, pas dënimeve absurde ndaj Benfica-s në shtator 1987, në atë ndeshje famëkeqe.



Musta ishte futbollist elitar, që përveç disa viteve "legjionari" në Rumani, pas vitit 1990, ka qenë besnik i fanellës së kuqe në futbollin vendas. Në fillim si futbollist i madh, por edhe si trajner.

I takon një brezi të tërë futbollistësh që sakrifkuan shumë dhe bënë që emri i Shqipërisë të dëgjohej në arenën ndërkombëtare edhe me

cilësi loje.

Është Mjeshtër i Merituar Sporti. Me Partizanin për disa sezone ka qenë edhe kapiteni ekipi dhe një lojtar kryesor edhe jashtë fushës, futbollist simbol.

Perlat Musta bën pjesë te kolosët e sportit. Një jetë me fanellën e kuqe, afro 18 vite si

lojtar dhe më pas si trajner, kryesisht me moshat. Teksa e pyet mjeshttrin se çfarë 'i dha' Partizani, ai përgjigjet: "Unë isha Perlati dhe Partizani më bëri Musta...".

Redaksia e "Shtypit Ushtarak" i uron: U shekullofsh me shëndet dhe pranë të dashurve të zemrës, Perlat Musta!



Kërcënimi i plastikës për shëndetin tonë

Në pesë deri në gjashtë vitet e fundit, ka pasur një shqetësim në rritje për kërcënimin që kontejnerët plastikë të të gjitha llojeve paraqesin për shëndetin tonë. Gjithnjë e më shumë, gjatë gjysmë shekullit të fundit apo më shumë, ka pasur një zhvendosje graduale nga kontejnerët e shisheve në plastikë dhe gjithashtu një lëvizje e përgjithshme nga qelqi dhe qeramika për shkak të peshës dhe brishtësisë së tyre. Në fillim, dukej sikur kontejnerët plastikë ishin gjëja tjetër më e mirë që do t'i ndodhte njerëzimit, veçanërisht në epokën e petrokimikeve.

Megjithatë, ka prova të mëdha se që nga fillimi i shekullit, më shumë se 1000 kimikate të ndryshme në përdorim sot në një gamë të tërë industrish mund të veprojnë për të prishur sistemin endokrin të shumë njerëzve të ndryshëm, pavarësisht nga gjinia e tyre. Këto kimikate të ndryshme gjenden gjithashtu në lloje të ndryshme të materialeve plastike dhe besohet se ato kanë gjetur mënyra të shumta për të rrjedhur në qarkullimin e njerëzve.

Ndërprerja që këto materiale mund të sjellin tani besohet të jetë në gjendje të intensifikojë ose të shkaktojë drejtpërdrejt shumë gjendje shëndetësore si disa lloje kanceri, obeziteti, diabeti i tipit 2 dhe sëmundje të ndryshme kardiovaskulare. Si rezultat, këto ditë ka prova në rritje se këto ndërprerje të identifikuar mund të kenë pasoja të rënda në gjendjen shëndetësore të një individi. Prandaj, ndërprerja e sistemit endokrin përfshin gjëndrat që janë të pranishme në zona të ndryshme rreth trupit dhe organet fundore mbi të cilat veprojnë këto hormone.

Tani, këto kimikate janë klasifikuar nga studiuesit si kimikate endokrine përçarëse (EDC) dhe thuhet se shifra e 1000 llojeve të ndryshme të këtyre kimikateve është në fakt një vlerësim shumë konservator. Pyetja e madhe, pra, është se ku gjenden këto materiale dhe si kanë arritur kaq shumë të përbëjnë një kërcënim të tillë për mirëqenien tonë. Në radhë të parë, natyra e kudogjendur e disponueshmërisë së këtyre substancave kimike rreth nesh është kryesisht për shkak të pranishë së tyre në një gamë të gjerë produktesh. Plastika që përmban këto EDC gjenden në çdo komb në tokë, pa përjashtim.

Këto materiale gjenden në lloje të ndryshme mobilie, lodra për fëmijë, materiale tekstili, kozmetikë, mjete motorike, mallra elektrike, tela dhe kablo, lloje të ndryshme ambalazhesh, materiale izoluese për disa vegla që përdorim në shtëpi dhe punë, prodhim ushqimi, magazinim dhe materialet e shpërndarjes, objektet e kujdesit shëndetësor dhe enët për të ngrënë dhe për të pirë.

Është kaq i përhapur në mjedisin tonë sot, sa që njerëzit e kanë lënë kryesisht përdorimin e filxhanëve të çajit për gota dhe filxhanë plastike. E gjitha filloi si një metodë alternative për të shijuar atë që konsiderohej si diçka e pëlqyer nga shtresat e mesme dhe të larta, pasi kryesisht, shumë njerëz në këtë nivel ekzistence ishin të sfiduar financiarisht në blerjen e produkteve qeramike që mund t'i shërbenin të njëjtit qëllim. Arsyeja tjetër ishte se plastika ka veti të shkëlqyera izoluese dhe mund të mbështetet në ruajtjen e nxehtësisë së çajit në një enë plastike ose të orizit të shijshëm në një frigorifer.

Sipas studimeve, ndërsa disa njerëz mund të ekspozohen ndaj këtyre kimikateve që çrregullojnë sistemin endokrin gjatë gjithë jetës së produktit që përfshin prodhimin, përdorimin dhe asgjësimin eventual të tij, të tjerët bien në kontakt me ta kur fillojnë të përdorin produktin e përfunduar deri në asgjësimin e tyre në fund të jetës. Është një prani vërtet e jashtëzakonshme në jetën tonë sot dhe kjo përfshin objekte aq të padëmshme si krehri plastik dhe furça e dhëmbëve të cilat janë të disponueshme në shumicën e shtëpive.

Ndërsa popullsia globale rritet, barra që i është ngarkuar njerëzimit nga prania e këtyre kimikateve në mjedisin tonë do të vazhdojë të rritet. Në një përpjekje për të përballuar këtë



rritje të popullsisë, prodhuesit e plastikës do të duhet të rrisin më tej prodhimin e tyre për ta përmbushur atë.

Kjo rritje parashikohet të rritet deri në një të tretën e vëllimit aktual të prodhimit gjatë pesë viteve të ardhshme. Për shkak të kësaj, pritet të ketë rritje të shkallës së sëmundjeve endokrine dhe ekspozimit të mëtejshëm ndaj këtyre EDC. Në një dokumentar të mirë-hulumtuar që lancoi "Sky News", thuhej se mbi 8 milionë tonë plastikë hyjnë në oqeanet çdo vit, duke vrarë jetën detare. Në atë kohë, dihej tashmë se përbërësit kimikë të këtyre materialeve të plastikës po hynin në zinxhirin tonë ushqimor, duke shkakuar ato që atëherë u përshkruan si pasoja të panjohura.



Në atë kohë, "Sky News" filloi atë që e quajti fushatën dixhitale të Shpëtimit të Oqeanit, e cila kishte si qëllim kryesor rritjen e ndërgjegjësimit për sfidën e mbajtjes së mbetjeve plastike në oqeanet. Por nuk janë vetëm oqeanet që përfshihen; Hulumtimet tregojnë se lumi Yangtze i Kinës është fajtori më i keq në botë, duke shkarkuar deri në 1.5 milion tonë plastikë në Detin e Kinës Jugore.

Gjithashtu në Azinë Jugore, lumi Chao Phraya që rrjedh nga zemra e Tajlandës në kryeqytet, Bangkok, dhe një nga rrugët ujore më të rëndësishme të atij vendi është i përmbatur me plastikë. Tani me tallje quhet Lumi Plastik, por kërcënimi i tij për shëndetin e njerëzve dhe aktivitetet bujqësore në të gjithë atë pellg është tashmë shumë real

me zhdukjen e peshqve nga vetë lumi.

greke: “nëse do të ketë luftë, ndoshta do të shohim se e vetmja gjë që mund të bëjnë oficerët grekë përveçse të flasin, është t’ja mbathin”. Megjithatë, Greqia ishte i vetmi vend ballkanik që zotëronte një forcë detare të konsiderueshme, e cila ishte jetike për Lidhjen për të parandaluar transferimin e shpejtë të përforcimeve osmane me anije nga Azia në Evropë. Kjo u vlerësua nga serbët dhe bullgarët dhe ishte faktori kryesor në fillimin e procesit të përfshirjes së Greqisë në Lidhje. Siç u shpreh ambasadori grek në Sofje gjatë negociatave që çuan në hyrjen e Greqisë në Ligë, “Greqia mund të sigurojë 600,000 njerëz për përpjekjet e luftës. 200,000 burra në terren dhe flota do të jetë në gjendje të ndalojë 400,000 burra që të zbarkohen nga Turqia midis Selanikut dhe Galipolit.

Ushtria greke ishte ende në riorganizim nga një mision ushtarak francez, i cili mbërriti në fillim të vitit 1911. Nën mbikëqyrjen franceze, grekët kishin adoptuar divizionin trekëndor të këmbësorisë si formacionin e tyre kryesor, por më e rëndësishmja, reformimi i sistemit të mobilizimit i lejoi vendit të nxirrte dhe të pajiste një numër shumë më të madh trupash sesa ishte rasti në 1897. Vëzhguesit e huaj vlerësuan se Greqia do të mobilizonte një forcë prej rreth 50,000 burrash, por ushtria greke nxori 125,000, me 140,000 të tjerë në Gardën Kombëtare dhe rezerva. Pas mobilizimit, si në vitin 1897, forca u grupua në dy ushtri, duke reflektuar ndarjen gjeografike midis dy teatrove operacionale që ishin të hapura për grekët: Thesalisë dhe Epirit. Ushtria e Thesalisë (Στρατιά Θεσσαλίας) u vendos nën komandën e Princit të Kurorës Konstandin, me gjeneral-lejtnant Panagiotis Danglis si shef të shtabit të tij. Kjo ushtri mbart pjesën më të madhe të forcave greke: shtatë divizione këmbësorie, një regjiment kalorësie dhe katër batalione të këmbësorisë së lehtë malore Evzones, afërsisht 100,000 njerëz. Pritej të kapërcente pozicionet e fortifikuara kufitare osmane dhe të përparonte drejt Maqedonisë jugore dhe qendrore, duke synuar marrjen e Selanikut dhe Manastirit. Pjesa e mbetur

prej 10,000 deri në 13,000 burra në tetë batalione u caktuan në Ushtrinë e Epirit (Στρατιά Ηπείρου) nën gjeneral-lejtnant Konstantinos Sapunxakis. Duke qenë se nuk kishte asnjë shpresë për të pushtuar Janinën, kryeqytetin e fortifikuar të Epirit, misioni fillestar ishte të bllokonte forcat osmane atje derisa të dërgoheshin përforcime të mjaftueshme nga Ushtria e Thesalisë pas përfundimit të suksesshëm të operacioneve.

Marina greke ishte relativisht moderne, e forcuar nga blerja e fundit e njësisve të shumta të reja dhe duke iu nënshtruar reformave nën mbikëqyrjen e një misioni britanik. I ftuar nga kryeministri grek Venizelos në vitin 1910, misioni filloi punën me mbërritjen e tij në maj 1911. Me fuqi të jashtëzakonshme dhe e udhëhequr nga Zëvendës Admirali Lionel Grant Tufnell, ajo riorganizoi tërësisht Ministrinë e Marinës dhe përmirësoi në mënyrë dramatike numrin dhe cilësinë e ushtrimeve në manovrim dhe qitje të flotës. Në vitin 1912, njësisia kryesore e flotës ishte kryqëzori i shpejtë i blinduar Georgios Averof, i cili kishte përfunduar në vitin 1910 dhe më pas ishte anija luftarake më e shpejtë dhe më moderne në flotat luftarake pjesëmarrëse. Ai u plotësua nga tre luftanije mjaft të vjetra të klasit Hydra. Kishte gjithashtu tetë shkatërrues, të ndërtaur në vitet 1906-1907, dhe gjashtë shkatërrues të rinj, të blerë me nxitim në verën e vitit 1912, teksa afrimi i luftës u bë i dukshëm

Megjithatë, në shpërthimin e luftës, flota greke ishte larg nga gatishmëria. Flota luftarake osmane ruajti një avantazh të qartë në numrin e anijeve, shpejtësinë e njësisve kryesore dhe, më e rëndësishmja, numrin dhe kalibrin e armëve të anijeve. Për më tepër, teksa lufta e gjeti flotën në mes të zgjerimit dhe riorganizimit të saj, një e treta e flotës (gjashtë shkatërruesit e rinj dhe nëndetësja Delfin) arriti në Greqi vetëm pasi kishin filluar luftimet, duke e detyruar marinën të riorganizonte ekuipazhet, të cilët për pasojë vuante nga mungesa e familjaritetit dhe trajnimit.

“ USHTRITË E KOMBINUARA TË SHTETEVE BALLKANIKE MPOSHTËN USHTRITË OSMANE FILLIMISHT NUMERIKISHT INFERIORE (SUPERIORE NË FUND TË KONFLIKTIT) DHE STRATEGJIKISHT TË PAFAVORIZUARA, DUKE ARRITUR SUKSES TË SHPEJTË.



Artileritë grekë me top 75 mm

Përtej James Blunt: Muzikantë të njohur që shërbyen në ushtri

JAMES BLUNT

James Hillier Blunt (lindur më 22 shkurt 1974), i njohur më mirë me emrin e tij skenik James Blunt, është një këngëtar-kantautor, muzikant dhe ish-kapiten i ushtrisë angleze.

Blunt u bë i njohur në vitin 2005 me publikimin e albumit të tij debutues në studio "Back to Bedlam", përpara se të arrinte famë botërore me këngët "You're Beautiful" dhe "Goodbye My Lover". Albumi shiti mbi 11 milionë kopje në mbarë botën, duke kryesuar listat në Mbretërinë e Bashkuar dhe arriti në vendin e dytë në Shtetet e Bashkuara. Albumi i tij i dytë "All the Lost Souls", i cili u publikua në 2007, kryesoi listat në mbi 20 vende dhe prodhoi këngën hit në 1973. Albumi i tij i tretë, "Some Kind of Trouble", u publikua në 2010, pas këngës kryesore "Stay the Night".

Albumi i tij i fundit, "Moon Landing", u parapri nga singëlli kryesor "Bonfire Heart", i cili arriti kulmin në numrin 4 në tabelën e këngëve në Mbretërinë e Bashkuar.

Blunt ka shitur mbi 20 milionë albume në mbarë botën, me albumin e tij debutues, "Back to Bedlam", duke u renditur si albumi më i shitur i viteve 2000 në Mbretërinë e Bashkuar. Ai është fitues i disa çmimeve dhe nominimeve, pasi ka fituar dy "Brit Awards", dy "MTV Video Music Awards", dy "Ivor Novello Awards" dhe ka marrë pesë nominime për çmimin "Grammy".

Blunt ishte oficer në Gardën e Ushtrisë Britanike, një regjiment kalorësie i Ushtrisë Britanike dhe vitin 1999, Blunt doli vullnetarisht për t'iu bashkuar një skuadre të "Blues and Royals", duke u vendosur me NATO-n në Kosovë. Fillimisht, e caktuar për të kryer zbulimin e kufirit Maqedoni-Jugosllavi, trupa e Blunt-it punoi përpara vijave të frontit, duke lokalizuar dhe synuar forcat serbe për fushatën e bombardimeve të NATO-s.

Gjatë shërbimit ushtarak në Kosovë, Blunt u njoh me punën e "Médecins Sans Frontières" (MSF ose "Mjekët pa Kufij"). Që atëherë, Blunt ka qenë një mbështetës aktiv i MSF, duke mbajtur ankande takim-dhe-përshëndetje në shumë nga koncertet e tij dhe duke filmuar dokumentarin "Kthimi në Kosovë", në të cilin ai vizitoi njerëzit dhe vendet që kishte hasur gjatë stacionimit atje.

"Return to Kosovo" është një film dokumentar i vitit 2007, i regjistruar në shtator 2006, kur muzikanti dhe ish-kapiteni i ushtrisë britanike James Blunt u kthye në Kosovë për të kryer një koncert për t'iu shërbyer trupave të NATO-s dhe për të vizituar vendet dhe njerëzit të cilët i kishte njohur gjatë shërbimit në Kosovë, në vitin 1999. Dokumentari u drejtua nga Steven Cantor, ndërthur pamjet e filmuara në vitin 2006 me videot personale të bëra nga Blunt në vitin 1999, si dhe pamjet e lajmeve nga konflikti i Kosovës. Blunt u ribashkua me tre përkthyesit me të cilët kishte punuar kur njësisia e tij u dërgua për herë të parë në Kosovë. Së bashku, ata kishin synuar të kërkonin familje me të cilat Blunt dhe të tjerët kishin ndërvepruar; në vend të kësaj, ata gjetën shtëpi të braktisura dhe të shkatërruara, ku këto familje kishin jetuar dikur. Grupi gjithashtu u kthye te një varr masiv që skuadroni i Blunt-it kishte qenë instrumental në identifikimin që iu bë; tani ishte një varrezë tradicionale, ku shumica e të vdekurve janë identifikuar dhe janë ngritur gurë varresh.

Blunt ndër të tjera gjithashtu performoi "No Bravery", një këngë për konfliktin që shkroi gjatë ushtrimit të detyrës në Kosovë.

WILLIE NELSON

Këngëtari, kompozitori dhe aktivisti, Willie Nelson është një nga zërat më të famshëm në muzikën country. Ai është i njohur



për punën e tij në mbështetje të fermerëve amerikanë dhe avokimit për legalizimin e marihuanës përmes rolit të tij si bashkëkryetar i Organizatës Kombëtare për Reformën e Ligjeve të Marihuanës (NORML).

Ai u rrit në Teksas. Pas viteve të hershme të trazuara, ai u transferua në Arkansas për të jetuar me gjyshërit e tij dhe filloi të luante tinguj për të shmangur punën në terren.

Pasi la shkollën e mesme, Nelson u regjistrua në Forcat Ajrore dhe shërbeu për rreth nëntë muaj përpara se të merrte një shkarkim mjekësor për shkak të problemeve të shpinës.

Dhe ndërsa ai nuk shërbeu shumë gjatë, ai ka qëndruar i apasionuar pas çështjeve të veteranëve gjatë gjithë karrierës së tij të rrëfyer si këngëtar, kompozitor, autor dhe aktor, duke mbrojtur për rritjen e kujdesit mjekësor për veteranët dhe duke mbështetur grupet e avokimit të veteranëve, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit për të pastrehë mes veteranëve.



TONY BENNETT

Me një karrierë që ka zgjatur më shumë se gjashtë dekada, Tony Bennett është zëri i gjallë i standardeve amerikane të pop-it, klasikëve të xhazit dhe, së fundmi, i dueteve bashkëkohore me legjenda të tjera si Amy Winehouse dhe Lady Gaga. Ai ka fituar 19 çmime "Grammy", dy çmime "Emmy" dhe është nderuar nga "Kennedy Center". Ai ka shitur më shumë se 50 milionë disqe në mbarë botën.

Megjithatë, përpara se të ishte Tony Bennett, ai ishte Anthony Benedetto, i cili rekrutua në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara në nëntor 1944 gjatë fazave përfundimtare të Luftës së Dytë Botërore. Si një këmbësor zëvendësues, ai shërbeu në të gjithë Francën dhe në Gjermani, dhe në mars 1945, ai u bashkua me vijën e frontit.

Gjatë luftimeve aktive, Bennett i shpëtoi vdekjes disa herë dhe mori pjesë në çlirimin e një kampi përqendrimi nazist, ku u liruan edhe të burgosurit e luftës amerikane nga Divizioni i 63-të.

Gjatë shërbimit të tij, ai gjithashtu këndoi me grupin ushtarak të Ushtrisë nën emrin skenik Joe Bari dhe luajti me shumë muzikantë që vazhduan të kenë karrierë muzikore të pasluftës. Pasi u shkarkua, Bennett studioi në krahun e teatrit amerikan.

GEORGE STRAIT

Këngëtari, kompozitori dhe producenti i muzikës country, George Strait, AKA "Mbreti i Country", konsiderohet nga shumë njerëz si një nga artistët më të njohur dhe me ndikim të muzikës country të të gjitha kohërave. George Strait është i famshëm për stilin e tij neo-traditionalist, pamjen e tij kauboj dhe 60 hitet nr. 1 të muzikës kountri të Billboard.

Ai u regjistrua në ushtri nga 1971 deri në 1975 dhe u vendos pjesërisht në Hawaii. Ndërsa ishte atje, ai filloi atë që do të bëhej një karrierë e përjetshme, duke kënduar me grupin e sponsorizuar nga ushtria të quajtur "Rambling Country". Angazhimi i Strait ndaj burrave dhe grave të Forcave të Armatosura ka vazhduar gjatë gjithë karrierës së tij të shkëlqyer. Ai madje shërbeu si zëdhënës i programit "Wrangler National Patriot", i cili rrit ndërgjegjësimit dhe fondet për veteranët ushtarakë amerikanë të plagosur dhe të rënë dhe familjet e tyre.





Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Vendi ku lindën patriotët...

Ata ishin patriotë të shquar çamë, luftëtarë revolucionarë, që pasi kishin mbaruar shkollën ushtarake morën pjesë si vullnetarë në Luftën e Spanjës (1936-1939). Ishin nga Agji e Parga, nga Spatari dhe Kurteci i Grikohorit të Çamërisë, morën pjesë në lëvizjen përparimtare të nxënësve dhe udhëhoqën këtë lëvizje. Me shumë shokë shqiptarë të ndihmuar nga Xhemal Kada shkuan vullnetarë internacionalistë në Luftën e Spanjës, për të luftuar përkrah popullit spanjoll kundër fashizmit dhe u rreshtuan në radhët e Brigadës XII "Garibaldi". Ranë dëshmorë në përlëshjet me fashistët në brigjet e Lumit Ebro në shtator-tetor 1938.

Thimjo Nasho Gogozoto, Zihni Murat Çami dhe Xhelal Abaz Çami kanë lindur në fshatrat e Çamërisë, jo shumë larg bregdetit Jonian, fshatra të bukur të Çamërisë. Banorët e këtyre fshatrave merreshin kryesisht me bujqësi e deri diku dhe me blegtori. Tokat ishin toka kodrinore me ujëra të shumta, që të gjitha familjet e fshatrave merreshin me rritjen e ullinjve, agrumeve, perimeve. Ndërsa një pjesë e banorëve merreshin me zejari. Aty bëheshin dhe panaire e pazare për të gjithë krahinën. Banorët ishin të gjithë të krishterë shqiptarë dhe ruanin gjuhën, zakonet, doket, këngët, dasmat e të gjithë kulturën popullore shqiptare. Shumica e tyre nuk dinin të flisnin asnjë fjalë greqisht. Në fshatra kishte vetëm nga një shkollë ku jepej mësim në gjuhën greke, ku pas shumë përpjekjesh u arrit të jepeshin 2-4 orë mësim në javë në gjuhën shqipe. Të gjithë këta lindën në një kohë kur përpjekjet dhe betejat e luftëtarëve çam, kishin arritur kulmin, bëhej përpjekje për të mbrojtur Janinën dhe Çamërinë nga pushtimi barbar grek.

Ra në luftën e madhe të Ebros

Thimjo Nasho Gogozoto lindi më 23 shkurt 1913. U rrit mes vështirësive ekonomike dhe luftërave që zhvilloheshin për mbijetesë. Varfëria në shtëpinë e tij kishte hedhur rrënjë. Fëmijët u rritën dhe babai donte t'i çonte në një shkollë shqipe, por qeveria greke në atë kohë nuk hapte shkolla shqipe dhe nuk pranonte fëmijë çamë për të mësuar gjuhën shqipe. Në këto kushte babai i dërgoi djemtë në Korfuz për të mësuar. Thimjo nisi shkollën e nënoficerëve. Shkolla ushtarake greke e nënoficerëve në Korfuz, Thimjos nuk i pëlqente. I njohur në Korfuz me patriotin Musa Demi, djemtë nga Çamëria shkojnë në Sarandë, ku në vitin 1927 aty hapet konvikti "Çamëria". Ishte maj 1931 kur Thimjo me Spiro Vllazero, Thanas Manushaqis dhe Vangjel Vangjeli shkuan në Normalen e Gjirokastrës, ku u regjistruan me ndihmën e Ahmet Demit ish-pedagog. Mësimet në shkollë tek ai zhvilluan dashurinë për atdheun dhe krenarinë për emrin shqiptar. Thimjo lexonte libra dhe gazeta që dilnin në Gjirokastër si "Demokratia", "Idea Kombëtare", "Bota e Re", etj. Këtu njohu dhe zuri miqësi me Ali Demin, Themo Vasin dhe nxënës të tjerë. Në nëntor 1934 shkolla Normale e Gjirokastrës u mbyll dhe nxënësit u dërguan në Normalen e Elbasanit dhe në Gjimnazin e Shkodrës. Thimja kishte dëshirë të bëhej mësues i gjuhës shqipe dhe shkoi në Elbasan. Këtu u njoh me të rinj me mendime revolucionare, si me Jordan Misja, Sami Baholli, Haxhi Kroj, Kareman Ylli, Sotir Caci, Vangjel Kaso, Dhimitër Grillo etj.

Në mbarim të Normale së Elbasanit, Thimjo merr vesh se qeveria Spanjolle u kishte bërë thirrje vendeve të botës për ndihmë. Grupet komuniste në Shqipëri kishin filluar regjistrimin e vullnetarëve për të mbrojtur Republikën e Re Spanjolle. Me mbarimin e shkollës dhe marrjen e diplomës së mësuesit, Thimjo u përgatit për t'u nisur gjoja për studime universitare në Francë. Regjimi i Zogut kishte vënë rregulla të forta për lëshimin e pasaportave për shtetet e huaja. Ai gjeti përkrahje dhe ndihmë tek Sotir Peçua nga Përmeti si dhe tek Koço Asimaqi. Ai ndoqi rrugën nga Saranda, në Korfuz për në Itali dhe në Francë. Në Paris kishte xhaxhain, Thanas Jorgo Gogozoto, i emigruar vite më parë, ku kishte hapur një kafe në një nga lagjet e jashtme të Parisit. Në fillim punoi në kafe, ku u njoh me shumë shqiptarë patriotë, Muharrem Demiri nga Arpica e Çamërisë. Ai u takua me Ali Kelmendin, me të cilin ishte takuar në një mbledhje në Elbasan, me Thanas Zikon, Abaz Shehuni, Halim Xhelu, Toger Asim Vokshi, Toger Zihni Murat Çamin nga Spatari, me Ramiz Varvaricën, Nezir Boshtinën, Xhelal Abaz Bajramin nga Kurteci, të cilët ndodheshin në Paris.

Grumbullimi i vullnetarëve bëhej në Paris dhe që aty grupe grupe të organizuara me tren niseshin drejt Pirenejve për të shkuan në Spanjë. Në Paris Thimjo u njoh me vullnetarët që prisnin të niseshin, si Kosta Dhimitrin nga Leskoviku, Zef Hotin nga Malësia e Shkodrës, Xhelal Abaz Çamin nga Kurteci, Ramiz Varvaricën nga Dibra, Urfi Agollin po nga Dibra, Zihni Muratin nga Çamëria. Pas kalimit me të gjitha peripeçitë të kufirit franko-spanjoll në malet e Pirenejve, qendra e grumbullimit të vullnetarëve internacionalistë ishte në Albacetë. Në këtë qendër e dorëzoi grupin që shoqëronte Xhemal nga Kosova. Në këtë grup bënte pjesë dhe Thimjo. Vullnetarët shqiptarë i priste Skënder Luarasi. Në mesin e korrikut të vitit 1938, filloi lufta e madhe e Ebros. Armata Republikane hidhet në një sulm që habiti botën mbarë, kaloi lum Ebro zuri 8.000 robër armiq dhe çliroi një territor prej 7.000 km². Në këtë luftë Spanja tërhoqi vëmendjen e të gjithë botës dhe fitoi simpatinë e njerëzimit përparimtar. Armiqtë nazistë dhe fashistë u tërbuan nga këto humbje të mëdha.

Ofensiva e përgjithshme që filloi më 25 korrik deri më 3 gusht pati sukses të madh. Pasi sulmoi Ebron realizoi objektivin e parë ose fazën

Bijtë e Çamërisë që ranë në Luftën e Spanjës

(NË KUADRIN E 85-VJETORIT TË RËNIES SË DËSHMORËVE TË ATDHEUT: THIMJO NASHO GOGOZOTO, ZIHNI MURAT ÇAMI DHE XHELAL ABAZ ÇAMI)



e parë të luftimeve duke marrë Gandezën. Armikut në këto luftime u shpartallua plotësisht. Në fazën e dytë, që ishte më e përgjakshme e që nisi me sulme e kundërsulme nga të dy palët. Trupat fashiste përdorën jo vetëm një korpmatë të re e të freskët dhe artileri të shumtë që arriti deri një grykë zjarri në çdo 10 metra, avionet të rëndë bombardues e mitralues të shumtë, tanke dhe të gjitha armët që kishin në dispozicion për të marrë hakun për humbjet e pësuar. Në forcat e Brigadës XII "Garibaldi", ku bënë pjesë dhe Batalioni IV me shumë shqiptarë, ndodhej në drejtimin e forcave kryesore armike ku pati shumë humbje. Thimjo Gogozoto ra heroikisht në moshën 25 vjeçare, më 28 shtator 1938.

Ra në betejë më të ashpër dhe më të guximshme

Zihni Murat Çami rridhte nga një familje e shquar patriotike nga Spatari i Çamërisë i lindur në vitin 1909. Familjarisht kishin emigruar në Shqipëri të dëbuar nga qeveria greke në vitin 1913. Familja e Haxhi Muratit mbajti qëndrim patriotik në vitet 1920, duke e përkrahur qeverinë e Fan S. Nolit dhe e priti me urrejtje të madhe pushtimin fashist të Shqipërisë. Zihniu, pas shkollës së mesme në Sarandë, nisi studimet në Akademinë Ushtarake në Modena të Italisë, të cilën e mbaroi me rezultate të shkëlqyera. Ai doli oficer i xhandarmërisë së qeverisë së Ahmet Zogut me gradën "togër".

Në fillim u emërua në vitin 1930 si Rrethkomandant i Pogradecit për xhandarmërinë. Në Pogradec togër Zihni Murati me fillimin e karrierës la përshtypje të mira. U njoh me familjen e Hysen Pargut, familje patrioti të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe u martua më të bijën e tij Hajrien në Pogradec. Për punë të mirë në detyrat e ngarkuara si rrethkomandant nga Pogradeci, togër Muratin e transferojnë në qarkun e Korçës me detyrën e Qark-komandantit të xhandarmërisë të qarkut. Togër Zihniu kërkonte dhe vendosi rregull në të gjithë qarkun gjë që nuk u pëlqente agallarëve të Korçës. Filluan ta quanin "çam të pabesë", sepse ishte koha kur Aziz Çami nga Janjari i Konispolit me banim në Filat i kishte bërë në vitin 1931 atentat Ahmet Zogut në teatrin e Vjenës, duke e pasur edhe shok por i kishte dalë i pabesë. Në Korçë si Qark-komandant togër Zihniu ndenji vetëm 6 muaj.

Zihniu dhe e shoqja Hajria zgjodhën Francën ku kishin plotë të njohur. Zihniu në kafetë ku grumbulloheshin shqiptarët u lidh ngushtë me Muharrem Demirin nga Arpica e Çamërisë, të Thanas Gogozotos nga Agji e Pargës dhe Xhelal Abaz Çamit nga Kurteci, takoi shumë oficerë të njohur si Asim Vokshin, Xhemal Kadën, Ramiz Varvaricën, Thimjo Gogozoto etj. Ai vendosi të shkojë në Luftën e Spanjës si vullnetar së bashku me të gjithë oficerët e njohur. Bisedoi me bashkëshortën, Hajrien, dhe e nisi për në Shqipëri. Të mbledhur së bashku Xhemal Kada, Thimjo Gogozoto, Xhemal Abazi dhe Zihni Murati të gjithë vullnetarë nga Çamëria martire, u nisën për në Spanjë. Xhelal Abaz Bajrami Çami dhe Zihni Murat Kapedani Çami u regjistruan në një batalion shqiptar dhe jo në batalionin grek. Ata ishin shqiptarë dhe zgjodhën batalionin "Dimitrov", sepse aty ishte kosovari nga Peja Xhemal Kada.

Beteja e Ebros që filloi më korrik 1938 dhe vazhdoi deri më 15 nëntor ishte nga më të ashpërta me një gjatësi fronti prej rreth 100 km. Më datën 28 shtator beteja u ndez nga më të ashpërta dhe nga më të guximshmet. Sulme e kundërsulme të të dy palëve. Avionet armik nazisto-fashist bënte bombardime të rënda e të pandërprera. Republikanët dhe vullnetarët kishin strehime të sigurta në përlëshjet

që bëheshin vazhdimisht ndërmjet tyre shokët binin njeri pas tjetrit. Më datën 28 shtator bie Thimjo Gogozotua, plagoset shumë rëndë Xhemal Kada, i cili vdes më 17 tetor 1938, plagoset për të katërtën herë Xhelal Abaz Çami shumë rëndë dhe gjatë bombardimit të paparë çdo gjë u bë tym e flakë. Nga një bombardim i rëndë vritet pa lënë asnjë gjurmë togër Zihni Murati, që ishte komandant kompanie dhe shok i ngushtë Xhemal Kadës dhe i Asim Vokshit. Ai ra dëshmor në Lumit Ebro të Spanjës, më 28 shtator 1938.

Katër herë i plagosur dhe përsëri luftonte...

Xhelal Abaz Çami, i lindur më 14 mars 1898, në fshatin Kurtec të Grikohorit, në një familje me tradita të shquara patriotike. Babai i Xhelalit ishte pjesëmarrës në Luftën e Janinës 1912-1913. Në vitin 1917, kur në Shqipëri e Jugut ishte pushtimi italian, Xhelali kaloi kufirin dhe u vendos në Sarandë. Në Shqipëri, si shumë çamë të tjerë, u regjistrua në vitin 1918 në Milicinë Vullnetare Shqiptare në qytetin e Delvinës.

Forcat e batalionit shkuan në ndihmë të punimeve të Kongresit Shqiptar që mbahej më 20 janar 1920, në qytetin e Lushnjës. Xhelali mori pjesë në Luftën e Vlorës 1920, dhe për trimëri u gradua së bashku me oficerët Adem Buletini, Azis Çami, Ahmet Demi, Ramiz Varvarica etj., qëndroi pranë qeverisë së Sulejman Delvinës, përkrah Fan Nolin dhe me rënien e qeverisë së tij, Xhelali emigroi në Francë. Ai u pranua anëtar i Partisë Komuniste Franceze dhe u njoh edhe me shumë shokë shqiptarë, që punonin në Francë.

Në muajin maj 1938 Thimjo së bashku me Xhelalin dhe shumë çamë të tjerë vendosën të nisen për në Spanjë. Të dy shkuan në batalionin e Brigadës XII Ndërkombëtare "Garibaldi", ku ishte dhe Xhemal Kada. Në kompaninë mitraljere, së bashku me Musa Fratarin që ishte edhe komandant i kompanisë mitraljere. Thimjo dhe Xhelali u radhitën në kompaninë ku ishte dhe togër Zihni Murat Çami.

Në marshim e sipër, në betejat më të përgjakshme në brigjet e Lumit Ebro, ku kishin rënë më parë Ramiz Varavrica, Kapiten Musa Fratarin dhe Asim Vokshi, u plagosën rëndë dhe më vonë vdiqën në spital Xhemal Kada dhe Xhelal Abazi. Atje ra si trimat Thimjo Gogozoto nga predhat e bombardimeve të avionit armik dhe u zhduk pa lënë gjurmë edhe trupi i togër Zihni Murati. Humbja ishte e rëndë.

Në luftime u plagos për të katërtën herë Xhelal Abazi, me plagë të rënda, për të cilat ai u tërhoq në spitalin e brigadës, në kujdesin e motrës së tij nga Shqipëria, Justina Shkupi, e cila iu bë motër e dytë dhe i shpëtoi jetën. Nga këto plagë, që i kishte kryesisht në gjoks dhe në mushkëri, ai mbas disa vitesh vdes në dispanserinë e Tiranës.

Pas plagosjes së rëndë, Xhelali u mjekua provizorisht në spitalin e frontit, por kur luftimet mbaruan, të gjithë vullnetarët u tërhoqën në Francë dhe u dërguan në kampin e përqendrimit si të internuar. Xhelali u largua nga Franca dhe erdhi në Shqipëri në muajin korrik 1952. Xhelali i shoqëruar nga oficeri i sigurimit, takoi nipërit dhe mbesat e tij në Elbasan, në Cërrik, në Tiranë, në Vlorë. I sëmurë rëndë nga procesi tuberkular i plagëve që kishte marrë në Luftën e Spanjës më 1938, Xhelali u shtrua në sanatoriumin e Tiranës, ku edhe vdiq, më 14 prill 1953.

Por, ai që derdh gjak dhe që bie dëshmor për atdheun e vet është një herë hero kombëtar, ndërsa ai që derdh gjak e bie për të çliuar e mbrojtur një komb tjetër është dy herë hero. Këta janë Heronjtë e Çamërisë dhe të popullit shqiptar, që u sakrifkua për një kauzë të shenjtë, atë të antifashizmit botëror.

Muzika shqiptare, ilaçi i shpirtit të një populli të etur për art

Muzika popullore Shqiptare përbën një ndër pasuritë më të çmuara të vendit. Në përshkrimet e studiuesve të huaj, të ardhur në Shqipëri gjatë shekujve XVIII-XIX është arritur përafërsisht në konkluzionin se pasuria kryesore e Shqipërisë është folklori muzikor.

Folklori muzikor bën një jetë aktive edhe sot, ndërkohë që gjurmët e lashtësisë së tij janë provuar që prej shekujve XIV-XIII p.e.s. Në objekte të ndryshme arkeologjike – skulptura, basorelieve, terakota, etj., janë përfiguruar qartë vegla popullore, që përdoren deri në ditët tona, valltarë, këngëtarë, kostume karakteristike, etj.

Folklori muzikor shqiptar është jashtëzakonisht i pasur, çka dhe shprehet në ekzistencën e muzikës vokale që nga forma njëzërëshe e deri tek shumëzërëshi; në muzikën me vegla popullore; muzikën me zë e vegla; muzikën për shoqërimin e valleve popullore, etj. Këtyre u shtohet dhe një fond i madh veglash popullore të klasifikuara në katër grupet tashmë të njohura si ideofone, membranofone, kordofone, areofone.

Folklori muzikor shqiptar e bën jetën e vet në një ndarje specifike, që lidhet me format e të shprehurit muzikor dhe me tipat kryesorë të instrumenteve të përdorur. Lumi i Shkumbinit, që përshkon mes për mes Shqipërinë, përveçse ndan dy dialektet kryesore të vendit në Gegë në Veri të Shkumbinit dhe në Toskë në Jug të Shkumbinit, shërben edhe si kufi natyror për klasifikimin e tipologjisë së folklorit muzikor. Në veri të lumit Shkumbin lokalizohet zona monodike e të shprehurit muzikor, e shoqëruar kjo me shkallët modale (diatonike apo kromatike) së bashku me vegla muzikore specifike për këtë zonë, si lahuta dhe çiftelia. Ndërkohë, për trevat që shtrihen në jug të lumit Shkumbin është karakteristik fenomeni i të shprehurit muzikor në iso-polifoni (ang. Poliphonie with burdon) me përdorimin e shkallëve pentatonike si dhe të instrumenteve specifik si gajde dhe bicula (fyell i dyfishtë). Krahas muzikës fshatare pa shoqërim me vegla (a capella), duke nisur nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, lindi dhe u kristalizua muzika popullore qytetare, që në Jug të Shqipërisë takohet kryesisht në qytetet: Korçë, Vlorë, Sarandë,



Delvinë, Përmet, Leskovik, Pogradec, me formacionin polifonik të Sazeve (të përbërë nga instrumente të importuar si klarineta, violina dhe fizarmonika, si dhe nga vegla popullore karakteristike si lahuta, dajre, fyell), ndërsa në Veri në qytetet Shkodër, Durrës, Elbasan, Kavajë, etj., shoqëruar nga ansamble popullore monodike

ose monodi me shoqërim (të përbërë nga vegla të importuara si klarineta, fizarmonika dhe violina, por edhe nga vegla të traditës popullore, si kemanhia, fyelli, etj.).

Nisur nga roli i dorës së parë që ka në traditën shqiptare, folklori muzikor studiohet si lëndë e veçantë në shkollat e mesme të përgjithshme, në ato artistike, si edhe në Akademinë e Arteve të Tiranës, ku formohen edhe etnomuzikologët e ardhshëm.

Regjistrimet e folklorit muzikor shqiptar nisin që prej viteve 1900 e këtej. Përpara viteve 1940 ato janë realizuar pranë shoqërive “Odeon”, “Colombia”, “Pathé”, “His master’s voice”. Regjistrime më të vona takohen edhe në formën e CD-ve, si CD me muzikë të “Familjes Lela”, prodhuar në Francë më 1992 nga Judigo; dy CD me muzikë toske të “Laver Bariut”, prodhuar përkatësisht në Greqi dhe Angli, etj.

Organizatrat dhe festivalet muzikore

Aktivitetet kryesore folklorike shqiptare janë Festivali Folklorik Kombëtar, mbajtur çdo pesë vjet, i cili ka filluar në vitin 1952 në qytetet Lezhë dhe Tiranë, për të vijuar më pas në dy qytetet muze me arkitekturë mesjetare, Gjirokastër dhe Berat; Festivali Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare në Elbasan; Takimi i Rapsodëve Lahutarë në Lezhë; Takimi i Sazeve në Korçë; Takimi i Grupeve Polifonike në Vlorë dhe Gjirokastër; Takimi i Grupeve dhe Shoqërive Folklorike (NGO) në Sarandë.

Organizatrat folklorike kryesore që veprojnë në Shqipëri, të krijuara kryesisht pas viteve 1990 me qëllim mbështetjen e folklorit dhe të traditave popullore në përgjithësi, janë: Elena Gjika – Përmet, Demir Zyko – Skrapar, Shoqëria Folklorike – Gramsh; Grupi Bilbili – Vlorë, Gjirokastër; Shoqata Tirana – Tiranë, Kastrioti – Krujë, etj.

Institucioni i vetëm shkencor që merret me studimin e folklorit është Instituti i Kulturës Popullore në Tiranë, i përbërë nga departamenti i etnomuzikologjisë dhe etnokoreologjisë dhe nga departamenti i etnografisë. IKP boton revistën periodike “Kultura popullore”. Pranë tij gjendet një arkiv shumë i pasur me mbi 6000 ekzemplarë të mbledhur në tërë Shqipërinë.

Disa nga librat më të rëndësishme mbi Folklorin Muzikor Shqiptar janë: “Gjurmime Folklorike”, i Ramadan Sokolit (Tiranë, 1981); “Polifonia labe”, i Spiro Shitunit (Tiranë, 1989); “Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë së Jugut”, i Beniamin Krutës (Tiranë, 1989); “Folklori muzikor shqiptar”, i Sokol Shupos (Tiranë, 1997)





Muzika profesioniste

Një burrë i njohur si “Lahutar”.

Paraqitet si një ndër traditat më të reja artistike shqiptare. Fillimet e saj i përkasin viteve 1920-1930 të shekullit XX, ndërsa zhvillimet më të rëndësishme i përkasin periudhës së mbas Luftës II Botërore.

Nga të dhënat e deritashme, studiuesi i njohur i traditave muzikore shqiptare, prof. Ramadan Sokoli, në librin e tij “16 shekuj” argumenton së paku kontributet e dy figurave të shquara shqiptare në artit kishtar mesjetar.

I pari prej tyre është Niketë Dardani, i njohur ndryshe si Niketa i Ramesianës, lindur rreth vitit 340 në Ramesianë të Dardanisë. Personalitet poliedrik, teolog, vjershëtor, muzikant, mik i afërt i Aurel Ambrason. N. Dardani emërohet në moshën 26 vjeçare Ipeshkëv i Ramesianës. Vepra e tij më e njohur është himni “Te Deum Laudamos”, i përhapur në Europë më 525, dhe mbi të cilin kanë shkruar muzikë kompozitorë të tillë si G. B. Lulu, G. F. Haendel, J. S. Bach, W. A. Mozart, F. Schubert, G. Verdi, G. Mahler, etj. Muzikanti tjetër, Jan Kukuzeli, i lindur në qytetin bregdetar të Durrësit rreth viteve 1078-1088, njihet si një ndër figurat më të mëdha të kishës bizantine. Arsimohet dhe afirmohet në Kostandinopojë, për t’u vendosur më pas në kishën “Laura e madhe” në malin i Shenjtë, ku harton edhe veprën madhore të jetës së tij, shkrimin neo-biznatin. Disa nga krijimet e tij kryesore janë Himnet Aniksandri, Kënga e Kerubinëve, Psalmi 107, Polilei 117, të pasqyruara pothuajse në të gjitha antologjitë e muzikës bizantine.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare jeta muzikore shqiptare pasurohet me forma të reja, të cilat i drejtohen mjedisëve të gjëra qytetare. Qendra të rëndësishme kulturore e muzikore të kohës janë qyteti i Shkodrës në Veri dhe ai i Korçës në Jug të vendit, ku krijohen formacionet e para orkestrale dhe korale laike. Sidoqoftë, përpjekjet më serioze për krijimin e një arti muzikor profesionist i gjejmë së pari tek kompozitori françeskan Pader Martin Gjoka (1890-1940), i cili punoi përgjithësisht pranë kishës françeskane të qytetit të Shkodrës, ku përveç muzikës fetare, kompozoi disa vepra

vokale dhe instrumentale, midis të cilave një simfoni, pjesë korale, pjesë për instrumente të ndryshëm, etj. Ndërkohë, Gjoka shquhet edhe si veprimtar i muzikës, duke formuar e drejtuar formacione të ndryshme instrumentale e vokale.

Brezi i parë i kompozitorëve shqiptarë të pas-Luftës II Botërore përbëhet nga një grup muzikantësh, pjesa dërrmuese e të cilëve u formuan në Konservatorin Cajkovski (ang. Tchaikovski) të Moskës, ndërsa të tjerët pranë shkollave perëndimore. Dy veprat kryesore me të cilat themelohet tradita muzikore profesioniste shqiptare janë “Sinfonia” (1956) e Çeks Zadesë (1927-1997) dhe opera “Mrika” (1958) e Prenk Jakovës (1917-1969), që të dy kompozitorë me origjinë nga Shkodra, dhe i pari i cilësuar shpesh herë si babai i muzikës profesioniste shqiptare.

Gjatë viteve 1950-1990

Gjatë viteve 1950-1990 tradita e re muzikore shqiptare bëri hapa të rëndësishëm përpara, duke ezauruar në një mënyrë apo një tjetër vonesën e gjatë në kohë. Repertori muzikor shqiptar plotësohet me të gjitha format e gjinitë tradicionale, që nga ato të muzikës së dhomës e deri tek ato skenike. Një rol përcaktues për këtë luajti ngritja për të parën herë në Shqipëri e institucioneve të tilla të rëndësishme muzikore, si Filarmonia e Shtetit, Teatri i Operas dhe Baletit, disa orkestra simfonike dhe ansamble korale në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit, si Shkodër, Korçë, Vlorë, Elbasan, Durrës, si dhe krijimi i sistemit të plotë të edukimit muzikor.

Zhvillimet muzikore shqiptare të kohës pësuan një rritje të ndjeshme që prej gjysmës së dytë të viteve 1960 me Koncertet e Majit të Tiranës, të cilat u mbajtën në mënyrë periodike nga viti 1967 deri më 1990 duke aktivizuar muzikantë e trupa profesioniste dhe amatore. Përgjithësisht muzika e kësaj periudhe ka një orientim tradicional klasik-romantik dhe një mbështetje të fortë në folklorin muzikor shqiptar. Përveç Zadesë dhe Jakovës, disa nga figurat kryesore të muzikës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX janë Tish Daija (1926), Nikolla Zoraqi (1929-1991), Tonin Harapi

(1928-1991), Feim Ibrahim (1935-1997), Shpëtim Kushta (1946), Thoma Gaqi (1948), etj. Në kushtet e izolimit të vendit, muzika shqiptare e kësaj periudhe, ashtu si të gjitha artet në përgjithësi, me përjashtim të përpjekjeve të rastit, e pati të pamundur avancimin drejt zhvillimeve bashkëkohore perëndimore.

Mbas viteve 1990, situata muzikore në Shqipëri njohu zhvillime krejtësisht të reja, të cilat synuan integrimin e shpejtë në strukturat artistike europiane. Një rol të rëndësishëm për këtë luajti formimi i shoqatave muzikore, si Shoqata e Muzikës së re Shqiptare (NAM, anëtare e Konferencës Europiane të Muzikës së Re) dhe Shoqata Mbarëshqiptare e Profesionistëve të Muzikës (seksioni shqiptar i ISCM), pranë të cilave është grumbulluar pjesa dërrmuese e kompozitorëve dhe interpretuesve të vendit, dhe që aktualisht shërbejnë si tribuna kryesore të krijimtarisë së re muzikore të kompozitorëve shqiptarë.

Institucionet Muzikore

Institucionet muzikore më të rëndësishme në Shqipëri janë Teatri i Operës dhe i Baletit, Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore (që të dyja në Tiranë), ku janë përqendruar muzikantët e kërcimtarët më të mirë të vendit. TOB, me seli në sheshin “Skënderbej”, ka një aktivitet permanent sezonal, ku vendin më të rëndësishëm e zënë shfaqjet e repertorit klasik e romantik; ndërsa AKVP, i përbërë nga grupi i valleve, i korit, orkestrës dhe solistëve, përfaqëson një institucion muzikor profesionist fare specifik, repertori i të cilit mbështetet kryesisht në përpunimin artistik të traditës muzikore e koreografike popullore.

Formacionet orkestrale më të rëndësishme të vendit janë Orkestra Simfonike e Teatrit të Operas dhe Baletit, Orkestra Simfonike e RTV, Orkestra Simfonike e Akademisë së Arteve. Dirigjentët kryesorë janë Ermir Krantja, Rifat Teqja, Ferdinand Deda, Bujar Llapë. Repertori koncertal i këtyre formacioneve përfshin muzikë që nga periudha baroke e deri në shekullin XX, por në përgjithësi ai anon për nga tradita klasiko-romantike dhe krijimtaria e autorëve shqiptarë.

Sistemi i edukimit muzikor në Shqipëri u themelua me hapjen për të parën herë në vitin 1947 të Shkollës së Mesme Artistike “Jordan Misja”, që me kalimin e kohës u shoqërua me disa shkolla të tjera të llojit në qytetet kryesore të vendit, si Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, etj. Më 1962 hapet Konservatori Shtetëror i Tiranës, tashmë i përfshirë si një Fakultet më vete në Akademinë e Arteve të Tiranës, ku bëjnë pjesë gjithashtu dhe Fakulteti Dramatik dhe ai i Arteve Figurative. Pranë shkollave të muzikës dhe Akademisë së Arteve ushtrojnë aktivitetin e tyre mësimor dhe koncertal orkestra simfonike dhe formacione të tjera të muzikës së dhomës së bashku me koret. Midis këtyre të fundit, një aktivitet intensiv, shpesh herë të vlerësuar me çmime ndërkombëtare, ka Kori i Vajzave të Akademisë së Arteve, me dirigjent Milto Vakon. Po në Tiranë, gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar, nën drejtimin e mjeshtrës së korit Suzana Turku, është krijuar edhe kori tjetër i njohur i vendit, “Pax Dei”.

Aktivitetet kryesore të jetës së sotme muzikore shqiptare mbahen kryesisht në Tiranë dhe pjesa dërrmuese e tyre realizohen nëpërmjet veprimtarisë së shoqatave muzikore, përmes të cilave janë afirmuar emra të rinj kompozitorësh, si Aleksandër Peçi, Sokol Shupo, Vasil. S. Tole, Endri Sina, etj., dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre koncertal ansamblet e specializuara për interpretimin e muzikës së re, SPECTRUM dhe ASMUS. Në vitin 1992 kompozitori Feim Ibrahim (i cili ishte dhe Presidenti i parë i Këshillit Kombëtar të Muzikës Shqiptare - anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës pranë UNESCO-s që në 1991), ideoi dhe krijoi festivalin “Ditët e Muzikës së Re Shqiptare”. Me iniciativën e Seksionit shqiptar të ISCM, qyteti i Tiranës pret në çdo sezon vjeshte muzikantë dhe artistë të huaj, pjesëmarrës në veprimtarinë komplekse “Vjeshta e Tiranës”, inauguruar në tetor 1994. Veprimtari të tjera permanente të fushës së interpretimit dhe krijimtarisë muzikore janë Festivali i Romancës Shqiptare (organizuar që nga viti 1994 nga Shoqata muzikore “Tonin Harapi”). Qendrat muzikore koncertale janë të shtrira në disa prej qyteteve kryesore të vendit; në Tiranë ndodhen midis të tjerash Salla e Koncerteve e Akademisë së Arteve, ajo e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës, Teatri Rubairat, etj.; në Shkodër salla e Teatrit Migjeni, në Korçë Salla e Koncerteve e Shtëpisë së Kulturës; në Elbasan salla e Teatrit “Skampa”; në Durrës, Salla e Koncerteve e Pallatit të Kulturës.

Folklori muzikor shqiptar është jashtëzakonisht i pasur, çka dhe shprehet në ekzistencën e muzikës vokale që nga forma njëzërëshe e deri tek shumëzërëshi; në muzikën me vegla popullore; muzikën me zë e vegla; muzikën për shoqërimin e valleve popullore, etj. Këtyre u shtohet dhe një fond i madh veglash popullore të klasifikuara në katër grupet tashmë të njohura si ideofone, membranofone, kordofone, areofone.



12 TË DREJTA STUDIMI

**NË AKADEMITË
USHTARAKE MË
TË MIRA NË SHBA**

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 12 (dymbëdhjetë) të drejta studimi si më poshtë vijon:

AKADEMIA USHTARAKE DETARE, 6 (GJASHTË) KUOTA.

AKADEMIA USHTARAKE "WEST POINT", 6 (GJASHTË) KUOTA.

**AFATI KOHOR PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT PRANË QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT ËSHTË DERI MË
27 TETOR 2023.**

[HTTPS://SHORTURL.AT/PKQ46](https://shorturl.at/pkq46)

TEL: 042 348 588